





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.01.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 06.12.2021

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, miraton vendimin për procesverbalin nga mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 06.12.2021.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 06.12.2021.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES INAUGURUESE TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari i Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti, ndërsa atë e kryesoi anëtari më i moshuar i kuvendit, z.Reshat Azizi.

Mbledhja është mbajtur më 06.12.2021 (E Hënë), në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari, z.Sokol Haliti, kryesuesi i kësaj seance, z.Reshat Azizi; asamblistët: Sokol Shaqiri, Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Majlinda Ostrogllava, Zejnepe Osmani, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisa Zejnullahu, ndërsa mbledhjen e lëshuan asamblistët nga Lëvizja Vetëvendosje. Në mbledhje morën pjesë edhe mysafirët e ftuar, KFOR-i, Policia, kleri fetar, shoqatat e dala nga lufta ,përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara dhe ato elektronike.

Kryetari, z.Sokol Haliti: Me lejoni të ju përshëndes të gjithëve Juve qytetar të Vitisë, përbërje e re e kuvendit komunal, ju të nderuar të pranishëm që jeni prezent! Para se ta thirri kryesuesin e kësaj seance solemne, inauguruese, më lejoni t’i thamë dy tri fjali të nderuar të pranishëm. E dini të gjithë që mbrëmë e kemi humb një mik të madh, një mik të botes demokratike, një luftëtar të madh të demokracisë, një mik të madh të Kosovës, senatorin Bob Dole. Kosovën e lidhin shumë me senatorin Bob Dole. Mua dje mu kujtua 31 Maji i vitit ’98, prandaj senatori Dole do të mbetet përherë në kujtesë të qytetarëve të Kosovës dhe të popullit të saj. Unë po ju lus në nderim të senatorit Bob Dole, që ta bëjmë një minutë heshtje. Çoftë i përjetësohem kujtimi për senatorin Dole. Atëherë e ftoj kryesuesin e kësaj seance, që e do rendin sipas moshës, z.Azizi.

z.Reshat Hazizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Mirë se keni ardh të gjithë ju musafir pa dallime, të gjithëve ju përshëndes, ju përshëndes zotëri kryetar, ju uroj për mandatin e ri, juve kolegë e kolege edhe juve ju uroj mandatin e ri. Dëshiroj që ju të jeni një zë i fort i taksapaguesve, i atyre që na kanë sjellë këtu, të votoni për të mirën e qytetarëve që dëshirat e tyre, kërkesat e tyre të shkojnë në vend pa dallime partiake. Kur të jet në pyetje e mira e taksapaguesve, e mira e

qytetarëve të Komunës së Vitisë të jemi të gjithë së bashku dhe t'i qojmë proceset përpara. Tani e ftoj sekretarin e kuvendit që të vazhdoj me verifikimin e këshilltarëve.

z.Fatlum Demiri: I nderuari kryetar i Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti, të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, zonja dhe zotëri, bazuar në rezultatet e Komisionit Qendror Zgjedhor të këtij viti, konstatojmë se delegatet e zgjedhur nga Lidhja Demokratike e Kosovës janë këta: Sokol Shaqiri, Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredin - Elezi, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Majlinda Ostrogllava, Zejnepe Osmani; nga Lëvizja Vetëvendosje delegatet që janë qertifiku edhe pse nuk po i shoh prezent jane keta: Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi; nga Partia Demokratike e Kosovës janë këta: Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi - Salihu, Zyrafete Rama, Anisa Zejnullahu; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Reshat Azizi. I nderuari kryesues, konstatojmë se kemi kuorum për vazhdimin e kësaj seance. Të lus të vazhdon me procedimin e pikave të rendit të ditës.

z.Reshat Azizi: Faleminderit zotëri sekretar! Tani kërkoj nga ju që të miratojmë rendin e ditës. Kush është që të punojmë me këtë rend të ditës, ju lutem me ngritje dore. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës. Ftoj të gjithë këshilltarët, që me ngritje në këmbë të bëjmë betimin për këshilltarët komunal.

Bazuar në nenin 35, paragrafi 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 24, paragrafi 24.6 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, në nenin 4 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

Unë _____ "betohem (ose deklaroj solemnisht), se do t'i kryej me nderë, besnikëri, pa anim e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Tani rend ditës kemi dhënies e betimit së Kryetarit të Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti.

z.Sokol Haliti: Faleminderit kryesues bazuar në ligjin për vetqeverisje lokale, Unë **Sokol Haliti** "betohem (ose deklaroj solemnisht), që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Vitisë, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë pa dallime".

z.Sokol Haliti: I nderuari kryesues, të nderuar këshilltarë komunal, të nderuar përfaqësues të institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë, përfaqësues të KFOR-it amerikan, përfaqësues të subjekteve politike e të organizatave të dala nga lufta, të nderuar veteranë të luftës, e veprimtarë të çështjes kombëtare, përfaqësues të bashkësive fetare, ish-kryetarë e zyrtarë komunal, të dashur mërgimtarë, aktivistë të shoqërisë civile e media, të nderuar pjesëmarrës në këtë seancë solemnë, ku jemi mbledhur për të zyrtarizuar përfaqësuesit e zgjedhur me votën tuaj të lirë, qytetarë të nderuar të Komunës së Vitisë! Para së gjithash dëshiroj t'ju falënderoj nga zemra për besimin e dhënë për të vazhduar mandatin e kryetarit edhe për katër vjet! Po ashtu shfrytëzoj rastin që të uroj edhe këshilltarët e rinj të zgjedhur nga vullneti i juaj i lirë dhe t'iu dëshiroj punë të mbarë e suksese. Me lejoni të ju drejtohem juve dhe të gjithë qytetarëve të komunës sonë, që me votën tuaj përcaktuat përgjegjësini për udhëheqjen e komunës në kate vitet e ardhshme, ju që me votën tuaj

na ngarkuat me një përgjegjësi të cilën sot zyrtarisht do ta marrim dhe do ta kthejmë në punë, në përkushtim dhe besim të mëtutjeshëm për të gjithë ju pa dallim feje apo nacionaliteti, duke punuar e bashkërenditur pa dallime partiake, plotësisht në interes të komunës sonë dhe të gjithë qytetarëve të saj. Rizgjedhja për kryetar të komunës efshtë detyrim dhe përgjegjësi për mua dhe bashkëpunëtorët e mi, me të cilët zotohem se, do të vazhdojë të punojë me seriozitet e përkushtim maksimal, për të mirën e përgjithshme publike në komunën tonë dhe për përmirësimin e jetës së secilit qytetar në çdo aspekt pa dallime.

Jam i vetëdijshëm se kemi shumë çështje për të zgjidhur, prandaj zotohem se do të jem pranë problemeve dhe kërkesave tuaja dhe do t'i përfundojmë të gjitha projeksionet e parapara për këtë mandat, në mënyrë që Vitinë ta bëjmë edhe më të jetueshme edhe me të zhvilluar. Konkretisht, gjatë katër viteve të ardhshme, do të fokusohem tek zhvillimi ekonomik, shëndetësia, kultura, rinia, sporti, arsimi, bujqësia, shërbimet publike si dhe shumë projekteve tjera të rëndësishme jetike. Përndryshe, në anën tjetër, do të jem i pakompromis ndaj të keqes, padrejtësive, shkeljeve e parregullsive. Do të vazhdojë të punojë ndershëm, me efikasitet të lartë e përgjegjshmëri, do të angazhohem për transparencë e llogaridhënie të plotë, si dhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, për të përmbushur rrugëtimin dhe sakrificën e gjeneratave të tëra që kanë punuar në këtë drejtim prej dekadash e deri tek përpjekjet për shtetndërtim dhe institucione të shëndosha dhe për të siguruar të ardhme të ndritshme për gjeneratat e reja, të cilat do të ndihen krenarë me të arriturat që do t'i gëzojnë.

E di që nuk është lehtë, por me kënaqësi dhe me plot energji kam marrë mbi supe përgjegjësinë e udhëheqjes së Komunës së Vitisë edhe për një mandat. Prandaj kërkoj bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj, që secili prej nesh të kryejë obligimet dhe punët që na takojnë, në mënyrë që gjërat të vijnë në vendin e vet, ashtu si duhet dhe me kohë. Konfirmoj edhe një herë se, jam i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë qytetarët pa dallim dhe me të gjitha strukturat dhe subjektet politike pa dallim, në të mirë të zhvillimit të gjithmbarshëm e të mëtutjeshëm të Vitisë. Për mua është nder i madh që të vazhdojë t'ju shërbejë, por njëkohësisht edhe emocion e përgjegjësi, për rrugën që kaluam e shtigjet e reja që do t'i hapim. Do të jeni dëshmitarë të një koncepti transformues e modern të Komunës së Vitisë.

Fare në fund, dua t'ju uroj shëndet të plotë, sepse tani kemi hyrë në vitin e tretë të pandemisë, e cila na shkaktoi vuajtje e vështirësi të mëdha, duke na marrë edhe shumë jetë njerëzish, për çka shprehi ngushëllimet e mia të sinqerta. Lutem që kjo të kalojë sa më shpejt e ne të gjithë t'i kthemi ritmit normal të punës dhe jetës. Krahas lutjeve, zotohem se bashkë me Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilin e kryesoj, dhe me mekanizmat tjerë institucional, do të vazhdojë me përkushtimin maksimal luftën kundër kësaj të keqe që e ka kapluar mbarë njerëzimin. Përndryshe, në të keq e në të mirë, do të jem 24 orë i çasshëm e në shërbimin tuaj.


Faleminderit të gjithëve! Zoti ju bekoftë Juve, Zoti i bekoftë miqtë tanë!

z.Reshat Azizi: Faleminderit zotëri Kryetar e urime! Të nderuar të pranishëm, me kaq konsideroj që mbledhja inauguroese e sotme përfundoj. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:30 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Reshat Azizi

